REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	19.07.2021
Referencë:	
Për:	**z.Imri Ahmeti** – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	**z.Fauz Xhemajli** – Nënkryetar i Komunës **z.Lulzim Qerimi** – Nënkryetar i Komunës
Nga:	**Anila Reçica Llugiqi** - Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	**RAPORT Mujor - QERSHOR - 2021**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit qershor, në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, konform gjendjes së krijuar me pandeminë globale Covid – 19.

Gjatë gjithë muajit është punuar me staf të plotë dhe orar të rregullt, por duke respektuar gjithmonë udhëzimet e IKSHPK-së.

Në raportimet javore e kemi paraqitur përafersisht punën e drejtoratit.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Kemi bërë raportin për muajin maj 2021,
- Kemi bërë kerkesa për shpenzim të buxhetit varësisht nga kerkesat dhe nevojat e departamentit,
- Kemi shenuar 12 qershorin, Ditën e Çlirimit të Lipanit me aktivitete Kulturore dhe Sportive,
- Është bërë përurimi i 3 shtatoreve në qytetin e Lipjanit,
- Është realizuar expozita e nxënësve të Shkollës Pamore "PICCASO" për nderë të Çlirimit të Qytetit të Lipjanit,
- Përurimi i shtatoreve të dëshmorëve Haredhin Bajrami dhe Xhavit Kozhani si dhe veprimtarit dhe humanistit Ruzhdi Shabani, janë bërë duke mbajtur seancën solemne në shtëpinë e kulturës "Tahir Sinani" në Lipjan,
- Është mbajtur turniri në shah për shenimin e Ditës së Çlirimit të Qytetit të Lipjanit,
- Është mbajtur akademi përkujtimore për nderë të ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit,
- Është lëshuar filmi dokumentar kushtuar dëshmorit Vezir Kolshi, pas përfundimit të akademisë përkujtimore me datë 14 qershor,
- Në objektin e shtëpisë së kulturës "Tahir Sinani" është shfaqur drama me titullin "Çelësi magjik" nga grupi i të rinjëve lipjanas të organizatës ART–POLIS,
- Është bërë vlerësimi i projekteve të OJQ-ve kulturore që kanë aplikuar në thirrjen publike të publikuar nga komuna, për mbështetje financiare,
- Është nderuar me kurorë lulesh dëshmori Lulzim Llugiqi në përvjetorin e rënjes,
- Është nderuar me kurorë lulesh fëmiu i rënë në ditën e fëmijëve në fshatin Shalë
- Është bërë përurimi i librit "Plojë e madhe" nga autori Sefer Tasholli,
- Janë vendosur kurora lulesh pranë shtatores së Adem Jasharit dhe janë nderuar të gjithë dëshmorët e komunës së Lipjanit duke iu vendosur kurora lulesh prane varreve dhe memorialeve të tyre.

STATISTIKAT

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuara nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
37	28	3	6	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje : Te hyrat:
6	5	24	1	12.00€

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Sektori për fëmijë	125	143	36	-	370	-
Sektori për të rritur	45	70	22	-	352	-

Tabela- 4, -- Raport për Biblotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit
207	207	29	0	0

Tabela- 5, -- Raport për Biblotekën në Shalë

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
-	-	-	-	-

Biblioteka ka hapur dyert edhe për lexues nga muaji shtator, me lirimin e masave në luftën kundër pandemisë globale Covid – 19, nga niveli qendror. Gjithashtu orari i punës së bibliotekës është kthyer deri në orën 19:00.

DISKUTIME PUBLIKE

Gjatë muajit qershor, nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

TAKIME TJERA

Gjatë muajit qershor janë realizuar takime fizike me palë, duke respektuar rekomandimet e IKSHPK-së për distancë fizike, duke mos përjashtuar edhe takimet online të cilat i kemi pasur si pjesë e aktiviteteve tona të përditshme.

SFIDAT

Me lirimin e masave anti covid, edhe sfidat e departamentit tonë kanë qenë më të lehta, pasi aktivitetet Kulturore, Rinore dhe Sportive janë liruar, por prapë shëndeti mbi të gjitha dhe aktivitetet tona janë realizuar konform rregullave të IKSHPS-së.